



OPOZITA ENDE PA PAJTIM PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT



Derisa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) mbështet shpërndarjen e Kuvendit, dy partitë e tjera opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duan zgjedhje të reja përmes

shkarkimit apo dorëheqjes së qeverisë së kryeministrit Albin Kurti. Shef i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se shtatori duhet ta gjejë Kosovën me qeveri të re, por e pranoi se ka mungesë pajtueshmërie për

këtë. "Deri tani ende nuk jemi në një situatë ku kemi dakordim mes grupeve parlamentare, që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme", ka thënë ai të premten pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit

QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN E NJËJTË PËR MARRËVESHJEN PËR BURGJET ME DANIMARKËN



**VETERANI I POLITIKËS BRITANIKE NË EVROPË,
SIR GRAHAM WATSON, THOTË SE GJYKIMI I
ISH-PRESIDENTIT THAÇI ËSHTË POLITIK**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**A DO TË SJELLË VDEKJA E RAISIT
NDRYSHIME NË POLITIKËN E IRANIT?**

**KOSOVA VLERËSON MBËSHTETJEN E
VAZHDUESHME TË KATARIT**

**PROFESORI RICHARD HALL PO
QËNDRON NË UP, DO TA MBËSHTESË
KËSHILLIN E ETIKËS**

EKONOMI



**SHQIPËRIA PËRGATITET PËR
REKRUTIMIN E DHJETËRA
MIJËRA PUNËTORËVE**

**TRAFIKU URBAN NËNSHKRUAN
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
ME TELEKOMIN E KOSOVËS**

SPORT



**KARRICA PËR ÇMIMIN
'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË:
SUKSES I GJITHË EKIPIT**

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

A do të sjellë vdekja e Raisit ndryshime në politikën e Iranit?

TEHRAN, 20 MAJ - Vdekja e presidentit të Iranit, Ebrahim Raisi, në një aksident ajror, shkaktoi tronditje në mbarë Republikën Islamike dhe rajonin më gjerë. Megjithatë, ajo nuk pritet të sjellë ndryshime të mëdha në politikën e brendshme dhe të jashtme të Teheranit, thonë ekspertët.

Udhëheqësi suprem Ajatollah Ali Khamenei, i cili e ka fjalën e fundit në të gjitha çështjet kryesore shtetërore, dhe Korpusi i fuqishëm i Gardës Revolucionare Islamike janë qendrat kryesore të pushtetit në Iran, ku autoriteti i presidentit është i kufizuar. “Vdekja e Raisit në vetvete nuk do të shkaktojë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në politikën e Iranit”, thotë Hamidreza Azizi, bashkëpunëtor në Institutin gjerman për Çështje Ndërkombëtare dhe të Sigurisë. “Presidenti është i dyti në komandë në hierarkinë e pushtetit të Republikës Islamike dhe udhëzimet strategjike i jep

udhëheqësi suprem”, shpjegon ai. Si president, Raisi mbikëqyri një shtypje brutale të protestave kundër establishmentit në vitin 2022, si dhe shtrëngimin e të ashtuquajturave ‘ligje të moralit’. Pasojë reale e vdekjes së presidentit ultra-konservator, sipas ekspertëve, mund të jetë lufta për pushtet midis forcave të vijës së ashpër të vendit.

Vdekja e tij mund t’i komplikojë edhe planet pasardhëse të Khameneit, pasi thuhej se ai do të bëhej udhëheqësi i ardhshëm suprem.

Raisi, ish-shef i gjyqësorit, ishte mbështetës i madh i Khameneit, ndërsa ky i fundit besojë se po e përgatiste atë si pasardhës të vetin.

Sanam Vakil, drejtoreshë e Programit të Lindjes së Mesme në Institutin Chatham House në Londër, thotë se Raisi “ishte i përshtatshëm” për këtë detyrë. Sipas saj, ai madje e modeloi jetën e tij sipas udhëheqësit suprem 85-vjeçar. “[Raisi] ishte një



funkionar besnik, i gatshëm për ta marrë pozitën e liderit suprem. Nuk duket se ka kandidatë të tjerë aq të përshtatshëm”, thotë ajo. Sidoqoftë, vdekja e Raisit la një vend bosh për t’u mbushur. Me ligjin iranian, zgjedhjet duhet të mbahen brenda 50 ditësh - kohë

gjatë së cilës institucioni klerik do të përpiqet të gjejë një zëvendësues të përshtatshëm. Tash për tash kandidatë janë kryetari i Parlamentit, Mohammad Bagher Qalibaf, dhe shefi i gjyqësorit, Gholamhossein Mohseni Ejei.

Azizi thotë se presidenti i ardhshëm mund të ketë “ndikim të rëndësishëm në trajektoren e përgjithshme” të pasardhësit të Khameneit. “Si rezultat, kjo do të çojë në rritjen e konkurrencës ndërkonservatore për t’u bërë president”, përfundon ai.

Prokurori i GjNP-së kërkon fletarrestime për Netanyahu dhe liderët e Hamasit

HAGË, 20 MAJ - Kryeprokurori i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP) ka thënë të hënën se ka kërkuar lëshimin e fletarrestimeve për kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, si dhe për liderët kryesorë të Hamasit - grupit radikal të shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Karim Khan tha se beson se Netanyahu, ministri izraelit i Mbrojtjes Yoav Gallant, dhe tre liderë të Hamasit - Yehia Sinwar, Mohammed Deif dhe Ismail Haniyeh - janë përgjegjës për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit në Rripin e Gazës dhe në Izrael, së paku nga 7 tetori 2023.

Prokurori duhet të kërkojë



lëshimin e fletarrestimeve nga një panel prej tre gjyqtarësh, të cilëve mund t’u duhen deri në dy muaj kohë për t’i shqyrtuar provat dhe për të vendosur nëse mund të procedohet.

Izraeli nuk është anëtar i kësaj gjykate dhe, edhe nëse lëshohen fletarrestimet, Netanyahu dhe Gallant nuk përballen me rrezik të menjëhershëm për ndjekje penale. Por, njoftimi i Khanit e

thellon izolimin e Izraelit, i cili po e vazhdon luftën në Gazë, ndërsa rreziku për t’u arrestuar mund ta bëjë shumë të vështirë për liderët izraelitë të udhëtojnë jashtë vendit.

Ndërkohë, Sinwar dhe Dief besohet se janë duke u fshehur në Gazë. Por, Haniyeh, lideri suprem i grupit radikal Hamas, është me bazë në Katar dhe shpesh udhëton nëpër rajon.

Benny Gantz, nga kabineti i luftës i Izraelit, e ka kritikuar ashpër njoftimin e Khanit, duke thënë se Izraeli lufton “me njërin prej kodeve më të rrepta” të moralit dhe ka një gjyqësor të fuqishëm që është në gjendje të kryejë hetime vetë. “Shteti i Izraelit po kryen njërin prej luftërave më të drejta në historinë moderne...

vendimi i prokurorit për të kërkuar fletarrestime është krim më vete i përmasave historike, që do të mbahet mend nga gjenerata të ndryshme”, tha ai.

Izraeli e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj një sulmi të Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor, ku u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë dhe u rrëmbyen rreth 250 të tjerë.

Lufta izraelite i ka vrarë më shumë se 35 000 palestinezë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra, sipas zyrtarëve të Hamasit.

Por, lufta izraelite ka shkakuar edhe krizë humanitare në Gazë, duke bërë që rreth 80 për qind e popullsisë të zhvendoset dhe qindra mijëra njerëz të vuajnë nga uria, sipas zyrtarëve të OKB-së.

Presidenti i ri i Tajvanit i bën thirrje Kinës t’i ndalë kërcënimet

TAIPEI, 20 MAJ - Presidenti i Tajvanit, Lai Ching-te, i ka kërkuar Kinës të hënën t’i ndalë kërcënimet ushtarake dhe politike, duke thënë se paqja është zgjidhja e vetme dhe se Pekini duhet ta respektojë zgjedhjen e popullit tajvanëz.

Lai, duke iu drejtuar turmës pranë zyrtares presidenciale në qendër të Taipeiit në fjalimin e tij inaugurues, e përsëriti thirrjen

për bisedime me Kinën.

Kina pretendon se Tajvani është territor i saj dhe i ka rritur kërcënimet për ta aneksuar atë me forcë nëse është e nevojshme. “Unë dua gjithashtu t’i bëj thirrje Kinës të mos e kërcënojë më Tajvanin politikisht dhe ushtarakisht, dhe ta marrë përsipër përgjegjësinë globale për Tajvanin për të punuar zellshëm në ruajtjen e

paqes dhe stabilitetit përgjatë Ngushticës së Tajvanit dhe në rajon, për t’u siguruar se bota nuk frikësohet nga shpërthimi i luftës”, tha ai.

Lai shtoi se “ne duam t’ia themi këtë botës: Tajvani nuk bën lëshime për demokracinë dhe për lirinë. Paqja është opsioni i vetëm dhe prosperiteti është synimi ynë për paqe dhe stabilitet afatgjatë”.



Tahiri: Kurti u vetizolua nga amerikanët, dikur na vizitonin sekretarët e shtetit

PRISHTINË, 20 MAJ - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se këto ditë Kosova është duke jetuar e izoluar.

Tahiri ka thënë se kryeministri Albin Kurti është vetizolu nga Amerika, teksa ka përmendur disa vizita të

zyrtarëve amerikanë. Ajo ka thënë se dikur Kosova vizitohej nga sekretarë shteti. “Absurde e izolime - Kosova u vetizolua nga Evropa, Rama u vetizolua nga Kosova - nuk u prit nga kryeministri i Kosovës (erdhi vet, shkoj vet). Kurti u vetizolua nga amerikanët për fajet e tij.

Vërejeni këto vizita nga zyrtarë të lartë amerikanë në Kosovë nuk janë të Departamentit të Shtetit, por të sektorit të diplomacisë publike. Dikur na vizitonin sekretarët e Shtetit e zëvendëssekretarët, sot në këtë absurd po jetojmë!”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.



Hapet edicioni i tetë i Prishtina International Theater Festival - Teatro, nga e gjitha bota vijnë në Prishtinë

PRISHTINË, 20 MAJ - Të hënën është mbajtur konferenca për medie e shfaqjes së parë “Muhammad Ali, the one and only” nga Bosnjë-Hercegovina, që do të hapë edicionin e sivjetmë të Prishtina International Theater Festival “Burbuqe Berisha” - PITF 2024.

Në konferencë morën pjesë drejtoresha artistike e festivalit Doruntina Alshiqi, koordinatorja e festivalit Valentina Cenaj, regjisorin i shfaqjes Dino Mustafic, aktorët Vedrana Bozinovic, Ermin Sijamija dhe Dino Bajrovic.

Alshiqi i uroi mirëseardhje ekipit nga Bosnjë-Hercegovina, duke shtuar se përmes këtij festivali edhe në edicionin e tetë tentohet që ekipet teatrale nga shumë vende të botës të sjellin në

Kosovë shfaqjet e tyre më të mira. Regjisorin i shfaqjes “Muhammad Ali, the one and only”, Dino Mustafic, u shpreh i lumtur për pjesëmarrjen në festival. Ai në emër të Teatrit Kombëtar të Sarajevës i përshëndeti të pranishmit, ndërsa shtoi se shfaqja duhet të mbetet surprizë, por e rëndësishme është që përmbajtja e saj flet për lidhjen mes babait dhe fëmijës, familjes dhe dashurisë.

Aktorët Vedrana Bozinovic, Ermin Sijamija dhe Dino Bajrovic folën për pjesët e tyre në këtë shfaqje, duke thënë se presin që publiku ta shijojë shfaqjen, kurse sa i përket çmimit, u shprehën se do të ishte i mirëpritur.



Nxjerrja ilegale e zhavorrit, sekuestrohen kamionë dhe ekskavatorë në Rahovec



RAHOVEC, 20 MAJ - Prokuroria Themelore në Gjakovë ka bërë me dije se aksioni për sekuestrimin e mjeteve të përdorura për degradimin dhe shkatërrimin e mjedisit është në vazhdim.

Pas një inspektimi të kryer nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është konstatuar se në disa fshatra të komunës së Rahovecit, ambienti po degradohet për shkak të aktivitetit ilegal të nxjerrjes së zhavorrit përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë.

“Prokurori koordinator për hetimin e Krimeve Kundër Mjedisit, ka urdhëruar iniciimin e rastit për veprën penale ‘Ndotja, degradimi ose

shkatërrimi i mjedisit’ nga neni 338 i KPRK-së. Gjithashtu, është urdhëruar sekuestrimi i një kamioni transportues, tre ekskavatorëve dhe një seperacioni me të gjitha pajisjet përcjellëse të përdorura në kryerjen e veprës penale”, thuhet në njoftim.

Prokuroria njofton se aksioni për sekuestrimin e mjeteve të përdorura në aktivitete të paligjshme do të vazhdojë deri në kapjen e të gjitha mjeteve dhe personave përgjegjës.

Prokuroria shton se mbetet e përkushtuar maksimalisht për luftimin e dukurive të tilla të kundërligjshme që degradojnë ambientin dhe u bënë thirrje qytetarëve për bashkëpunim në luftimin e këtyre dukurive.

Pas reshjeve të shumta në Kosovë, situata është në kontroll

PRISHTINË, 20 MAJ - Pas të reshurave të shiut që kanë ndodhur të dielën në mbrëmje në Kosovë, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, së bashku me zëvendësuesin e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, Shefki Abdullahun dhe kryeinspektorin për Menaxhimin e Emergjencave,

Kastriot Lajqi, kanë dalë në terren për ta parë nga afër gjendjen dhe punën e zjarrfikësve.

Zëvendësministri Dobra me këtë rast ka vizituar disa zona, në veçanti pikën në lagjen Veternik dhe fshatin Dobratin të komunës së Graçanicës. Me këtë rast, zëvendësministri Dobra ka konstatuar se të gjitha

njësitet e zjarrfikësve janë mobilizuar plotësisht për ta menaxhuar situatën dhe për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve që janë prekur nga kjo situatë. Ai, po ashtu, falënderoi zjarrfikësit, pasi u konstatua se falë punës së tyre situata është nën kontroll dhe të gjitha pengesat janë mënjanuar.





Opozita ende pa pajtim për shpërndarjen e Kuvendit

Derisa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) mbështet shpërndarjen e Kuvendit, dy partitë e tjera opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duan zgjedhje të reja përmes shkarkimit apo dorëheqjes së qeverisë së kryeministrit Albin Kurti. Shef i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se shtatori duhet ta gjejë Kosovën me qeveri të re, por e pranoi se ka mungesë pajtueshmërie për këtë. “Deri tani ende nuk jemi në një situatë ku kemi dakordim mes grupeve parlamentare, që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme”, ka thënë ai të premten pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 MAJ - Grupet parlamentare kanë arritur të pajtohen të hënën për thirrjen e një seance parlamentare për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, megjithëse e gjithë opozita ka kohë që kërkon vazhdimisht që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Gjatë një mbledhjeje të Kryesisë së Kuvendit, shefja e grupit parlamentar të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Mimoza Kusari-Lila, tha se nuk ka kërkesë zyrtare për shpërndarjen e Kuvendit. “Ka vetëm kërkesë për debatin për qeverisje, që pritet të trajtohet të premten. Ky është propozim i

grupit parlamentar të AAK-së, me të cilin ata kanë propozuar edhe rrëzimin e qeverisë. Ne nuk e mbështesim dhe natyrisht konsiderojmë se nuk ka arsye të votohet në favor të kësaj kërkesë”, tha ajo. Mandati i qeverisë përfundon në fillim të vitit 2025, por partitë opozitare ka kohë që kërkojnë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, duke e cilësuar atë si të “dëmshme për vendin”. Kusari-Lila tha se nuk kanë frikë nga shkuarja në zgjedhje, por shtoi se nevojitet uniteti i opozitës për ta bërë të mundur këtë. Derisa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) mbështet shpërndarjen e Kuvendit, dy partitë e tjera opozitare, Lidhja

Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duan zgjedhje të reja përmes shkarkimit apo dorëheqjes së qeverisë së kryeministrit Albin Kurti. Abelard Tahiri, shef i grupit parlamentar i PDK-së, tha se shtatori duhet ta gjejë Kosovën me qeveri të re, por e pranoi se ka mungesë pajtueshmërie për këtë. “Deri tani ende nuk jemi në një situatë ku kemi dakordim mes grupeve parlamentare, që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme”, tha ai. Shef i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, nguli këmbë që qeveria e Kurtit të marrë përgjegjësinë për, siç tha, “dështimet e saj” përmes dorëheqjes. “Shpërbërja e Kuvendit në këtë fazë nënkupton një dalje për qeverinë Kurti, në njëfarë forme marrjen e fajit nga Kuvendi për dështimin e qeverisë. Shpërbërja duhet të vijë vetëm atëherë kur ta shkarkojmë një qeveri të dëmshme, vetëm atëherë kur të japë dorëheqje ajo, por në asnjë situatë Kuvendi të marrë një përgjegjësi që nuk i takon”, tha Tahiri. Javën e kaluar kryeministri Kurti zhvilloi një takim me Memli Krasniqin, kryetarin e PDK-së, me të cilin bisedoi për zgjedhjet e reja. Pas takimit, Kurti tha se zgjedhjet do të ishte mirë që të

mbaheshin në pranverë, ose në vjeshtë të këtij viti. Dy partitë e tjera opozitare, LDK dhe AAK, nuk pranuan të takohen me Kurtin për këtë çështje. Por, Kurti ka zhvilluar edhe një takim lidhur me çështjen e zgjedhjeve, me drejtuesit e dy partive më të vogla, që janë pjesë e qeverisë aktuale: Donika Gërvallën dhe Faton Pecin nga partia Guxo, dhe Mimoza Kusari-Lilën nga Alternativa. Për shpërndarjen e Kuvendit, nevojitet mbledhja e 40 nënshkrimeve për mocionin paraprakisht, i cili pastaj duhet të votohet nga 80 ligjvënës. Prej se Kosova është bërë shtet i pavarur në vitin 2008, asnjë qeveri e zgjedhur nuk e ka çuar deri në fund mandatin katërvjeçar. Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se LDK-ja dhe AAK-ja, nëse nuk kanë fuqi politike për ta nxitur dorëheqjen e kryeministrit, atëherë alternativa e tyre është se kjo qeveri ta përfundojë mandatin qeverisës. “LDK-ja dhe AAK-ja, nëse nuk kanë fuqi politike për ta nxitur dorëheqjen e kryeministrit, refuzojnë votën e tyre për shpërndarjen e kësaj legjislature, atëherë alternativa e tyre është që kjo qeveri ta përfundojë mandatin qeverisës

dhe të shkojmë në zgjedhje të rregullta. Nëse LDK-ja dhe AAK-ja si parti opozitare mendojnë se kjo qeveri i ka sjellë shumë dëme vendit dhe duhet të ndalohet kjo formë e qeverisjes?! Nëse tani i kanë të renditura shumë argumente për ngecjet dhe dështimet e kësaj qeverie, në disa fusha të politikëbërjes, si: në zhvillimin ekonomik, në qeverisjen llogaridhënëse, transparente dhe pa korrupsion, fuqizimin e aleancave dhe partneritetit ndërkombëtar, rrugëtimin euroatlantik, anëtarësimin në KiE, dialogun me Serbinë etj. S’di pse alternativën e tyre politike duhet ta fokusojnë në formë, se si i ndërpritet mandati kësaj qeverisje?! Gjithnjë forma ka rëndësi se si një veprim politik pranohet dhe perceptohet nga publiku, por jo mbi përmbajtjen. Përmbajtja është thelbësore në politikë”, ka deklaruar Kryeziu. Ai ka thënë se më shumë sesa forma, se si të arrihet ndërprerja e një mandati të një qeverie, politikisht për opozitën është zgjidhje më e mençur ndërprerja e një mandati të qeverisë para kohe sesa shkuarja në zgjedhje të rregullta. “Dhe përmbyllja e një mandati qeverisës dhe shkuarja në zgjedhje të rregullta janë formë e ndikimit dhe perceptimit në publik!”, ka theksuar Kryeziu.

MASHTI u bënë thirrje komunave të bashkëpunojnë për ndërtimin e çerdheve të reja



PRISHTINË, 20 MAJ - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, së bashku me zëvendësministrin Taulant Kelmendi, kanë folur në lidhje me ndërtimin e çerdheve, kopshteve dhe rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm. Duke folur për prioritetet e kësaj qeverie, ministria Nagavci tha se që nga marrja e mandatit është punuar me shumë përkushtim dhe angazhim që të krijohen kushte për përfshirjen dhe

përmirësimin e qasjes së fëmijëve në edukimin e hershëm. Ministria foli për arritjen e rezultateve të dukshme në përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe fizike, finalizimin e Ligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme, rishikimin dhe miratimin e kurrikulave, përmirësimin e kompetencave të edukatoreve në implementim të kurrikulës së re. Ndërsa sa i përket infrastrukturës fizike, sipas legjislacionit në fuqi, është kompetencë dhe përgjegjësi e

komunave inicimi i procedurave për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve. Ministria Nagavci tutje ka përmendur edhe letrën e nisur tek të gjithë kryetarët e komunave, për të kërkuar angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre në sigurimin e lokacioneve për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve, me qëllim që secilit fëmijë t'i mundësohet qasja e edukimit në fëmijërinë e hershme. Nagavci më tutje tha se Ministria e Arsimit gjatë vitit të kaluar ka

bërë një analizë dhe vlerësim të nevojave për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve në nivel të Republikës së Kosovës, njëkohësisht në të gjithat takimet me DKA është kërkuar nga komunat që t'i nisin procedurat për ndarjen e lokacioneve që plotësojnë kriteret për ndërtim dhe t'i sigurojnë projektet arkitektonike për ndërtimin e çerdheve. Ndër të tjera, ministria Nagavci ka folur edhe për projektet tipike për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve, hartimin e katër

projekteve tipike modulare të parafabrikuara dhe ndarjen e buxhetit të nevojshëm për investimin dhe ndërtimin e institucioneve parashkollore. Ndërsa zëvendësministri i Arsimit, Taulant Kelmendi, foli për nënshkrimin e marrëveshjes pesëvjeçare me Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian për Investime nga IPA për edukimin në fëmijërinë e hershme, si dhe planifikimin e sigurimeve të fondeve të mjaftueshme nga buxheti i shtetit.

Profesori Richard Hall po qëndron në UP, do ta mbështesë Këshillin e Etikës

Prishtinë, 20 maj - Rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, dhe prorektori prof. Faton Berisha, e mirëpritën profesorin dr. Richard Anthony Spurgeon Hall, i cili po qëndron në UP, për ta mbështetur Këshillin e Etikës të universitetit, në kuadër të programit Fulbright Specialist, të financuar nga qeveria amerikane. Dr. Hall, koordinator dhe profesor i filozofisë etike në Universitetin Shtetëror të Karolinës së Veriut në Fayetteville, ka një karrierë të gjatë dhe të pasur akademike. Me një formim të gjerë në filozofi, ai ka mbaruar studimet në Universitetin e Bostonit, Universitetin Dalhousie dhe Universitetin e Torontos, ku ka marrë titullin

Ph.D. Gjatë qëndrimit të tij në Universitetin e Prishtinës, dr. Hall do të ndihmojë në çështje të ndryshme si transparenca, shqyrtimi i rasteve në kohë dhe shumë të tjera që lidhen me Këshillin e Etikës. Ai do ta sjellë ekspertizën e tij të gjerë në çështje të etikës akademike, për ta mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të praktikave më të mira institucionale brenda universitetit. Ky bashkëpunim shënon një hap të rëndësishëm për përmirësimin e standardeve akademike në UP, duke sjellë një perspektivë të re dhe përvojë ndërkombëtare. Prof. Hall do të qëndrojë në UP gjatë tre muajve të ardhshëm.



Sekuestrohen 19 motoçikleta nga policia në Pejë

Pejë, 20 maj - Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë ka vazhduar realizimin e planit operativ “Motoçiklistët kundërvajtës” në qytetin e Pejës. Me këtë rast janë sekuestruar 19 motoçikleta të llojeve të ndryshme, ndërsa për kundërvajtësit janë lëshuar gjoba për

kundërvajtjet: mosposedimi i lejes për vozitje, mosposedimi i kategorisë përkatëse, ngasje e mjetit pa regjistrim dhe kundërvajtje të tjera. Aktivitete dhe detyra të shumta policore, që janë të planifikuara në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë

në Pejë, do të vazhdojnë në mënyrë intensive në ditët në vijim, pa asnjë tolerim ndaj secilit kundërvajtës. Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë u bënë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e komunikacionit.



Veterani i politikës britanike në Evropë, Sir Graham Watson, thotë se gjykimi i ish-presidentit Thaçi është politik

Prishtinë, 20 maj - Drejtori i organizatës “Zëri Perëndimor i Kosovës”, veprimtari Sali Bislimi, ka takuar në Milano të Italisë ish-kryetarin e Aleancës Liberal-Demokratike të Evropës, shumë vjet deputet i Parlamentit Evropian dhe ish-kryetar i Komisionit për Drejtësi në PE, Sir Graham Watson. Bislimi dhe Watsoni kanë biseduar për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë, Gjykatën Speciale dhe për shqiptarët jashtë Kosovës. Sipas postimit të Bislimit në “Facebook”, edhe Watsoni ka shprehur mendimin se Gjykata Speciale është gjykatë politike. “Gjykata Speciale kundër presidentit Thaçi është thjesht politike! Nder dhe kënaqësi të ndaj disa momente të shkëlqyera në Milano të Italisë me njeriun e madh të politikës evropiane, ish kryetar i Aleancës Liberal-demokratike të Evropës, shumë vite deputet i Parlamentit Evropian dhe ish-kryetar i



komisionit për drejtësi në PE, z. Graham Watson. Duke biseduar gjitha çështjet që lidhen me Evropën dhe Kosovën në procese integruese, me thotë këtu politika evropiane duhet të jetë e bashkuar dhe jo me standarde të dyfishta për dikën nënë dhe dikën njerë, siç thuhet tek ne. Me

modelin që ka sot Evropa nuk funksionon drejt demokracia. Evropa duhet të bëhet Federale ku e drejta e shumicës vendos si e vetmja mundësi për të marrë forcën krahas sfidave që kemi në raport me kontinentet tjera. Si e shoh gjykimin që kemi në Hage kundër presidentit Thaçi dhe të

tjerët, ku viktimat gjykohen dhe agresori serb anashkalohet?. Kjo për mua është thjesht politike. Gjërat duhet të ndryshojnë dhe për këtë na duhet bashkim në vlerat e liberaldemokracisë për t'i konfrontuar ekstremet djathtiste të cilat do të pengojnë aderimin e vendeve tjera në Bashkimin

Evropian”, ka shkruar Bislimi në “Facebook”. Meqenëse Britania është larguar nga BE-ja, Watsoni në zgjedhjet parlamentare të BE-së në qershor garon për deputet me Partinë Liberal Demokratike të Italisë - me listën e shteteve të bashkuara të Evropës. Watsoni nëpërmjet Sali Bislimit kërkon edhe votën e shqiptarëve me të drejtë vote në Itali. “1 milion shqiptar të Shqipërisë etnike që gjinden në Itali, sidomos ata që janë në verilindje, duhet ta konfirmojnë votën për njeriun që do ta kemi në krah për të ardhmen e vendit tonë! Anglo-amerikanët ishin ata që i dhanë drejtësinë popullit më të vuajtur të Evropës - Kosovës sonë, që sot padrejtësisht përpjekjet tona për liri po gjykohen në Hagë. Takimin tonë shumë të frytshëm e begatoj edhe zonja Rita Watson dhe djali im, Adriani, i cili edhe ngriti çështjen për veriun e Kosovës dhe paqen në rajon”, ka shkruar Sali Bislimi.

Përurohet rinovimi i Klinikës së Onkologjisë

Prishtinë, 20 maj - Rinovimi i Klinikës së Onkologjisë, qendrës së vetme në Kosovë për trajtimin e pacientëve të prekur me kancer, është përfunduar të hënën pas një investimi mbi gjysmë milion euro. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se klinika është “transformuar në mënyrë fort domethënëse për mjekët dhe infermierët por, para së gjithash, për pacientët”. Klinika, e cila është pjesë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, do t'i ketë 60 shtretër tani, nga 45 sa kishte para rinovimit, tha Kurti. Shpeshherë pacientët në këtë klinikë presin në radhë me orë të tëra për të gjetur shtrat për të marrë kimioterapi. Numri i shtretërve do të rritet në 110 në të ardhmen, sipas



kryeministrit. Ndërkohë, ministri i Shëndetësisë,

Arben Vitia, tha se nuk do të ketë më listë të pritjes për pacientët që

kërkojnë shërbime në këtë klinikë. “Jam shumë i lumtur që në një

klinikë kaq të rëndësishme dhe jetike pacientët tash e tutje do të marrin shërbime shumë më cilësore, pa listë të pritjes dhe me qasje në barna esenciale”, tha Vitia. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2023 u kontrolluan 30 000 persona në onkologji, ndërsa janë konfirmuar 1 224 raste të reja me kancer. Në këtë klinikë në vitin 2022 ishin kontrolluar apo kishin marrë shërbime 47 351 persona, ndërkaq 1 736 ishin raste të reja. Klinika e Onkologjisë në Prishtinë është e vetmja qendër në Kosovë, ku të prekurit me kancer marrin kimioterapi apo trajtime të tjera të nevojshme për ta. Brenda 24 orëve aty mesatarisht marrin shërbime rreth 400 pacientë që vijnë nga qytete të ndryshme të Kosovës.

Limaj me bashkatdhetarë në Gjermani, i falënderon për përkrahjen

Prishtinë, 20 maj - Pas takimeve në Itali dhe Zvicër, turin e takimeve me mërgimtarë kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir

Limaj, së bashku me bashkëpunëtorë të partisë, e kanë zhvilluar edhe me mërgatën në Gjermani. Kryetari Limaj i ka falënderuar

nga zemra për organizimin, bashkëbisedimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që diaspora, kjo vlerë e madhe e kombit tonë ka dhënë ndër

vite për Kosovën, si dhe për projektet politike të Nismës që gjithnjë për interes kanë të mirën e qytetarëve.



Qeveria miraton Projektligjin e njëjtë për marrëveshjen për burgjet me Danimarkën

Prishtinë, 20 maj - Qeveria e Kosovës ka njoftuar të hënën se e ka miratuar Projektligjin e njëjtë për ratifikimin e një Traktati, që kishte arritur me Danimarkën për strehimin në burgjet kosovare të të burgosurve nga Danimarka, disa ditë pas dështimit të Kuvendit për ta ratifikuar atë. “Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është ratifikimi i Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze”, tha qeveria në një komunikatë për medie.

Blerim Sallahu, zëvendësministër i Drejtësisë i Kosovës, tha për “Radion Evropa e Lirë” se ky është Projektligji i njëjtë të cilin Kuvendi dështoi ta miratojë të enjten. “Po, ne kemi negociuar me danezët dhe jemi pajtuar që të shkojë i njëjti draft në qeveri dhe në Kuvend”, tha Sallahu.

Pas dështimit në Kuvend, Projektligji duhej të kthehej në qeveri për t’u nisur nga pika zero, sipas rregullores.



Kosova dhe Danimarka e nënshkruan letër-pëlqim për dërgimin e 300 të burgosurve nga shteti danez në Kosovë në dhjetor të vitit 2021. Në prill 2022, dokumenti u shndërrua në Traktat, sipas të cilit, ishte paraparë që transferimi i të burgosurve të bëhej në fillim të vitit 2023. Por, Kuvendi dështoi ta kalojë Traktatin të enjten, pasi ai mori vetëm 75 nga 80 votat e nevojshme të deputetëve.

Qeveria duhet ta dërgojë në Kuvend këtë projektligj tani në tentimin e dytë për ratifikim,

megjithëse nuk ka pasur mbështetje për të nga një pjesë e opozitës.

Me ligjin në Kosovë, marrëveshjet ndërkombëtare mund të ratifikohen vetëm me votat e dy të tretave të deputetëve.

Çfarë parasheh Traktati?

Traktati ka kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh. Aty parashihet që Danimarka të marrë në shfrytëzim qeli, të vetme dhe të përbashkëta, në burgun e Gjilanit - pjesa lindore e Kosovës. Në

këmbim të kësaj, Kosova parashihet t’i fitojë mbi 200 milionë euro.

Nga shuma 200 milionë euro - sa parashihet të përfitonte Kosova - 30 milionë planifikohen të shkojnë për energji të ripërtërishme, ndërsa pjesa tjetër për investime në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Danimarka, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, do t’i dorëzojë Kosovës një tarifë fillestare prej pesë milionë eurosh.

Ndërsa pagesa do të bëhet në norma tremujore, gjatë 12 muajve

të parë të shfrytëzimit të burgut, në pajtim me numrin e të burgosurve që objekti mund t’i strehojë.

Sipas Traktatit, Danimarka nuk do të dërgojë të burgosur të dënuar për vepra terroriste, të burgosur të dënuar për krime të luftës dhe të burgosur të diagnostikuar me çrregullime të rënda mendore, të cilët kanë nevojë për kujdes mjekësor jashtë burgut.

Udhëheqësit dhe gardianët në burgun e Gjilanit do të jenë nga shteti i Danimarkës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Autoritetet në Danimarkë kanë thënë më herët se kapacitetet e burgjeve të tyre janë mbushur 100 %, pasi numri i të burgosurve është rritur për gati 20 % nga viti 2015.

Ekspertë të sigurisë në Kosovë kanë thënë më herët për REL-in se nuk ka vend për t’u shqetësuar për situatën e sigurisë nga ardhja e të burgosurve nga Danimarka. Por, përfaqësues të disa organizatave joqeveritare kanë thënë se ky transferim mund të ndikojë në standardin e të burgosurve lokalë.

350 kandidatë i nënshtrohen testit kualifikues të kandidatëve për pozitat e 24 prokurorëve të rinj të shtetit

Prishtinë, 20 maj - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) organizoi mbajtjen e Testit Kualifikues në kuadër të procesit të rekrutimit të njëzetekatër (24) prokurorëve të rinj të Republikës së Kosovës, i cili është mbajtur në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtri.

Ky test është zhvilluar në prani të vëzhguesve dhe monitoruesve ndërkombëtarë të EULEX-it dhe OSBE-së, paraprakisht Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit hartoi pyetjet për kandidatët që fituan të drejtën për të marrë pjesë në këtë testim. Në këtë test morën pjesë 350 kandidatë, prej tyre 192 meshkuj dhe 158 femra, prej të cilëve tre janë pjesëtarë nga radhët e minoriteve, dy boshnjakë dhe një turk, që kanë aplikuar përmes sistemit online të menaxhimit të dosjeve dhe



përmes dorëzimit të kopjeve fizike, me email dhe postë të rregullt.

Në këtë proces të rekrutimit kanë qenë të rezervuara katër pozita për minoritetin serb, por nuk ka

pasur asnjë aplikacion.

Me këtë rast, Kryesuesi i Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, Blerim Isufaj, së bashku me anëtarët e tjerë, ka mbikëqyrur rrjedhën e

plotë të mbajtjes së testit kualifikues.

Rrjedhimisht, në kuadër të monitorimit dhe vëzhgimit të këtij procesi ishin edhe prokurorë të Zyrës së

Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë të prokurorive të vendit, prokurorë të deleguar nga Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, prokuroritë themelore dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë nga radhët e EULEX-it dhe OSBE-së.

Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit është duke vazhduar punën në vlerësimin e të gjitha testeve dhe pas përfundimit të vlerësimit të tyre, sipas rregullores, do të publikohet lista e kandidatëve të cilët kanë kaluar testin dhe lista e kandidatëve që nuk kanë kaluar testin.

Në vijim do të organizohen edhe fazat e tjera të testimit sipas standardeve më të avancuara, të cilat përbëhen nga testi me shkrim dhe intervistimi i kandidatëve.

Kosova vlerëson mbështetjen e vazhdueshme të Katarit

Prishtinë, 20 maj - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim ministren për Zhvillim Social dhe Familje të Katarit, Maryam bint Ali bin Nasser Al-Misnad.

Katari ka qenë mbështetës i vazhdueshëm i Kosovës, ndaj Osmani e ka falënderuar ministren Al-Misnad, si dhe lidërshin e Katarit, në krye me Emirin Tamim bin Hamad bin Khalifa Al Thani.

Presidentja Osmani ka theksuar


se Kosova vlerëson thellësisht mbështetjen e vazhdueshme të Katarit, veçanërisht në ndihmën për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, por edhe për ofrimin e ndihmave humanitare gjatë dhe pas luftës.

Më tej, presidentja Osmani ka nënvizuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të raporteve me Katarin dhe, në këtë kontekst, ka përmendur fushën e mirëqenies sociale, mbështetjen për invalidët e luftës, sektorin e shëndetësisë,

turizmin si dhe projekte të tjera investuese.

Në takim, ndër të tjera, u diskutua edhe për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve mbështetëse të familjes, duke përfshirë programet e fokusuara në mirëqenien e fëmijëve dhe grave.

Të dy bashkëbisedueset shtruan nevojën për thellimin e bashkëpunimit dhe eksplorimit të nismave të përbashkëta nga të cilat do të përfitojnë të dy shtetet.



Trafiku Urban nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Telekomin e Kosovës

PRISHTINË, 20 MAJ - Kryeshefi ekzekutiv i Trafikut Urban, Burim Maraj, ka nënshkruar marrëveshje me menaxherin e Shitjes dhe Kujdesit në Telekomin e Kosovës, Kreshnik Domi.

Marrëveshja synon të ofrojë

shërbime për stafin e Trafikut Urban, duke lehtësuar komunikimin. Kryeshefi Maraj konfirmoi edhe njëherë angazhimin e ndërmarrjes për përmirësimin e shërbimeve për të gjithë punonjësit dhe qytetarët.

Kreshnik Domi, menaxher i shitjes dhe kujdesit në Telekomin e Kosovës, u shpreh se janë të lumtur që kjo marrëveshje do të ndihmojë në lehtësimin e përditshmërisë së punonjësve të ndërmarrjes.



Shqipëria përgatitet për rekrutimin e dhjetëra mijëra punëtorëve



TIRANË, 20 MAJ - Shqipëria prej vitesh vuan mungesën e fuqisë punëtore. Për ta lehtësuar këtë problem, qeveria është në negociata me Filipinet për një marrëveshje që do t'i sillte mijëra punëtorë. Përfaqësuesit e biznesit - kryesisht të sektorit të turizmit dhe manifakturës, që përballen me mungesë të theksuar punëtorësh - thonë se e mirëpresin këtë hap. Ekspertët dhe aktivistët nuk janë të gjithë në një mendje: për disa, një marrëveshje e tillë është e vonuar, e për disa të tjerë nuk garanton sukses. Të dhënat aktuale në uebfaqen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit tregojnë se bizneset i kanë të shpallura 5 500 vende të lira pune. Numri i punëkërkuesve, ndërkaq, është rreth 74 mijë, sipas Institutit të Statistikave.

Shqipëria “në radhë” për punëtorë nga Filipinet

Gjatë një takimi me përfaqësues të biznesit pak ditë më parë, përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë në Shqipëri bënë me dije se qeveria është në negociata për të sjellë punëtorë të huaj të kualifikuar. “Ministria e Ekonomisë po bën përpjekje të mira për të marrë punonjës cilësorë nga tregu i huaj. Ajo që po them si një e re që do të ndodhë shumë shpejt, është që jemi në përfundim të një kontrate me një shtet që ka punonjës të kualifikuar në disa industri, përfshirë atë të turizmit, por edhe të veshjeve”, tha Albin Gega, drejtor i përgjithshëm i Punësimit dhe Arsimit Profesional në Ministrinë e Ekonomisë. Ai tha se kjo marrëveshje do të mundësojë që, krahas trajnimeve dhe rritjes së cilësisë së punëtorëve, të plotësohen edhe nevojat e tregut për punonjës të

kualifikuar.

Më pas ishte kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, që në një intervistë për televizionin “Klan” bëri me dije se për cilin shtet bëhet fjalë. “Po bëjmë negociata me Filipinet. Po ta shikosh radhën e vendeve që nga Austria e vende të tjera... plot. Tridhjetë e tetë vende evropiane janë në radhë për të nënshkruar marrëveshje me Filipinet për krahun e punës”, tha Rama.

Ai nuk foli për shifra, por përfaqësues të biznesit dhe ekspertë të punësimit thonë se po diskutohet për 30-40 mijë punëtorë të kualifikuar.

Referuar shifrave zyrtare të Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë, prej vitit 2019 deri në vitin 2023 janë dhënë 24 590 leje pune për shtetas të huaj, por nuk ka asnjë të dhënë se sa prej tyre janë aktualisht në Shqipëri.

Pjesa më e madhe e tyre vjen nga Turqia, Bangladeshi, Nepali, India dhe Italia. Ata, kryesisht, janë të

punësuar në sektorët e turizmit, manifakturës dhe ndërtimit.

Një studim i qendrës “Studime Ekonomike dhe Sociale”, i publikuar tre vjet më parë, tregonte se grupmosha 18-40 vjeçe dhe pjesa më e arsimuar e tyre kërkojnë të largohen nga Shqipëria për “një punë të dinjitetshme, paga dhe kushte më të mira”.

Studimi tregonte, gjithashtu, për ndryshimin e thuajse të gjitha tendencave. Kështu, nëse në vitin 2007 ishte tendenca të emigronin persona të pakualifikuar dhe persona të paarsimuar, më 2019 rezultoi se dëshironin të migronin më shumë persona me arsimim të mesëm dhe profesional, e sidomos ata me arsimim universitar. Gjithashtu, nuk synohet më Italia apo Greqia, por Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar.

Po sipas studimit, të rinjtë që studiojnë jashtë Shqipërisë nuk duan më të kthehen.

Aurora Barçi, e lindur dhe rritur në Burrel, u largua nga Shqipëria në vitin 2010 dhe nisi studimet në Universitetin e Torinos në Itali, në degën “Bankë, bursë e sigurime”. “Italia kishte shumë përparësi financiare dhe ofronte bursa studimi, si dhe kushte shumë të mira për studentët, si: konvikte të rehatshme, ushqim cilësor me çmime të reduktuara në mensat e universiteteve, taksa minimale për studentët që merrnin bursë, abonim për transportin publik dhe sigurim shëndetësor me çmim të reduktuar”, thotë Aurora, duke shtuar se një tjetër përparësi ishin bursat e studimit shtesë, që u jepnin studentëve mundësinë për të punuar në ambiente të ndryshme universitare si, për shembull: laboratorët e informatikës, zyrat e informimit etj. “Këto bursa varionin nga 100 deri në 300 orë në vit dhe jepeshin në bazë të meritokracisë, me pagesa nga 9 deri në 11 euro për orë”, tregon ajo për “Radion Evropa e Lirë”.

KEDS-i vazhdon shtrimin e superpërçuesit nga nënstacioni i Rahovecit në atë të Malishevës

RAHOVEC, 20 MAJ - KEDS-i ka vazhduar shtrimin e superpërçuesit në linjën 35 kV nga nënstacioni i Rahovecit në atë të Malishevës. Linja është e gjatë mbi 15 kilometra dhe KEDS-i tashmë ka shtrirë disa kilometra. Përmes këtij investimi, që

shkon mbi 3 milionë euro, KEDS-i po gjen zgjidhje për furnizim me energji elektrike për të gjithë qytetarët e Malishevës.

Ata janë ballafaquar me vështirësi në furnizim me energji elektrike, sidomos gjatë dimrit si pasojë e mungesës së

aseteve transmetive që janë nën menaxhimin e KOSTT-it. Ndërtimi i superpërçuesit që parashihet të përfundojë muajin e ardhshëm do të zgjidhë këtë problem deri në ndërtimin e nënstacionit nga ana e KOSTT-it për këtë komunë.



Shkencëtari i madh mysliman i shekullit XI – el-Biruni



Nga. Eduart CAKA

Hyrje

Si një ndër qytetërimet më me shumë ndikim dhe kontribut për njerëzimin, islami i ka dhënë shumë të dijes njerëzore. Në kulmin e lulëzimit të këtij civilizimi janë arritur zhvillime të mëdha në fusha të shumta të shkencës. si: matematikë, algjebër, astronomi, mjekësi, botanikë, filozofi, logjikë, etikë, e shumë fusha të tjera. Emra, si: Farabiu, Ibni Sina (Avicenna), Ibni Rushd (Averroes), Ibni Haldun, Xhabir bin Hajjan, janë vetëm një pjesë shumë e vogël e dijetarëve dhe e shkencëtarëve, të cilët me zbulimet dhe kërkimet e tyre hodhën themele të shumë shkencave moderne. Padyshim që një element i ri që qytetërimi islam solli, ishte një paradigmë e re, e cila konsistonte në përdorimin e etikës dhe të objektivitetit nga shkencëtari në studimin që ai zhvillonte, duke i dhënë shkencës një dimension të ndryshëm zhvillimi nga ai që ekzistonte dhe zhvillohej në gjeografitë përreth. Një shembull i mirë në këtë rast është Ebu Rejhan Muhammed bin Ahmed el-Biruni, i cili me arritjet shkencore i dha njerëzimit një shem-

bull shumë të mirë të metodologjisë shkencore dhe elementit të objektivitetit në dije dhe në shkencë.^[1] Biruni, i cili njihet me lakabin “el ustadh”^[2] për studiuesin është i njohur, por edhe enigmatik. Ai njihet nga studiuesit e shumtë për faktin se në lidhje me të janë shkruar artikuj e libra, e janë mbajtur konferenca e simpoziume. Por, nga ana tjetër, ai mbetet i panjohur për shumë njerëz, sepse veprat e tij kanë mbetur të papërkthyer dhe një pjesë e mirë e punimeve të tij gjenden në formën e dorëshkrimeve. Sado cilësore të jenë studimet në lidhje me të, nëse nuk mundemi ta lexojmë Birunin në a veprat e tij origjinale, nuk mund të thuhet se e njohim mirë atë. Gjithsesi, me literaturën që ka në dorë studiuesi i ditëve tona e ka të mundur të formojë dije mbi jetën, aktivitetin dhe veprat e tij. Burimet më të hershme që japin të dhëna mbi Birunin, janë pothuajse dy shekuj pas vdekjes së tij. Vepra më e rëndësishme që flet për të është *Mu'xhemu'l-Udeba* e Jakutit (v. 1229).^[3] Në literaturë, emri i tij kalon në dy forma, si “Biruni” ose “Bejruni”. Siç shprehet edhe vetë, Ebu Rejhan Muhammed bin Ahmed el-Biruni ka lindur në vitin 973 në zonën e Harezmit.^[4] Në ndonjë

burim ai kalon edhe me lakabin Harezmi, pra në emrin e rajonit nga i cili ai vinte. Por, pas matematicienit të madh me famë botërore Harizmit, për të mos u ngatërruar, ai është përmendur në literaturë me emrin Biruni. Në lidhje me familjen, rreth origjinën së tij ka pak të dhëna. Sa i përket jetës private studiuesit shprehen se ai nuk ishte martuar dhe e kishte kaluar jetën pa familje. Ndërsa, kuptimi i fjalës “Biruni” me të cilin ai është thirrur është me origjinë perse, dhe do të thotë “provincial, ai që vjen nga jashtë”.^[5] Mendohet që ai ka lindur në qytetin Kas të rajonit të Harezmit, që sot ndodhet brenda kufijve të Uzbekistanit.^[6] Vetë ai do të shkruajë edhe një libër mbi historinë e vendit të tij të lindjes, ku jep një listë të sundimtarëve dhe disa monedha të vjetra të gjetura në Harezm. Për fat të keq, libri nuk ka arritur në ditët tona dhe njihet vetëm nga citimet që i janë bërë.^[7] Biruni ishte shquar qysh në fëmijëri për karakterin e tij të dhënë pas dijes. Mësuesi i parë i tij ka qenë Ebu Nasr Mansur bin Ali bin Iraku. Gjithashtu ka të dhëna për dijetarë të tjerë, nga të cilët ai kishte marrë mësim, siç mund të përmenden Ebu Nasr el-Mansur dhe Jahja el-Mesihi.^[8] Që në moshë të vogël

është marrë në sarajet e Harezmsahëve, ku ka kaluar një pjesë të mirë të rinisë së tij.^[9] Kjo i siguronte atij edhe një mbështetje politike, e cila ishte tepër e rëndësishme në kohën, si për lëvizjen në vende të ndryshme, por edhe kushte të mira në aspektin financiar, në mënyrë që të kishte më shumë hapësirë për kërkimet shkencore. Pas rrëzimit të Harezmsahëve, Biruni do të mbetet pa mbështetje politike, dhe në moshën 22-23-vjeçare ai do ta lërë Kasin për të kaluar në Rej (Teheran).^[10] Aty, dhe më pas në Bagdat, ai do të takohet me dijetarë të kohës, si Hoxhandi dhe Ebu'l Vefa Buzxhani, takime të cilat do të ndikojnë në pjekjen e tij shkencore. Në të njëjtën kohë, ai do të krijojë marrëdhënie të mira me sunduesit e Samanitëve, Zijaritëve dhe Gaznevive, të cilat ishin fuqi të kohës. Madje, ai kishte hyrë në shërbimin e sundimtarit të Zajirive, Kabus bin Vashmgirit, duke ia dedikuar këtij të fundit njëren ndër veprat më të mira të tij, *el-Asaru'l-Bakije*. Më vonë, në vitin 1009, do të kthehet në Harezm me ftesë të sunduesit të Gyrgenxhit Ebu'l-Hasen Ali bin Mejmunit, ku qëndron shtatë vjet. Në këtë periudhë është marrë me shumë

shkenca, si: algjebër, gjeometri, astronomi, gjeodezi, mjekësi, histori, gjeologji, kronologji, histori religjionesh, gjeografi, fizikë, biologji etj. Mësohet që ai njihje gjuhë të shumta, si: arabisht, persisht, hebraisht, suriakisht dhe greqisht. Me pushtimin e Harezmit nga sundimtari sulltan Mahmudi i Gaznes, në vitin 1017, thuhet se janë marrë me vete rreth 5 mijë pengje, ku kishte shumë dijetarë, e midis të cilëve ndodhej edhe Biruni.^[11] Ai është mbajtur rob për disa kohë në kalanë e Nandanasë. Studiuesit theksojnë se midis Gazneli Mahmudit dhe Birunit kishte patur gjithnjë një ftohtësi.^[12] Gjatë kësaj kohe ai njihet me kulturën dhe mendimin indian. Nuk dihet se sa herë ka vajtur në Indi, por mësojmë se ka qëndruar atje për rreth 30-40 vjet. Gjithashtu, dimë që ai e kishte mësuar sanskritishten nga robërit e luftës në Gazne. Gjatë kësaj kohe ka shkruar kryeveprën e tij *Kitabu't-Tahkik ma li'l-Hind*. Përveç të dhënave të rëndësishme të sistematizuara mbi kulturën dhe njerëzit e Indisë, Biruni këtu jep informacione të ndryshme edhe mbi tokën, reshjet, florën dhe faunën të cilat kanë qenë për shumë kohë të vetmet burime mbi këtë gjeografi të largët për shumë studiues. Kjo është dhe

arsyeja që shumë studiues e kanë cilësuar Birunin si indianologun më të madh të të gjitha kohërave.^[13] Pas vdekjes së sundimtar Mahmudit në vitin 1030, në fron erdhi djali i tij Mes'udi, i cili ndryshe nga i ati do ta respektojë Birunin, duke e ftuar në palatin mbretëror me detyrën e këshilltarit për dijen e shkencën. Gjatë kësaj periudhe ai e ka vijuar aktivitetin shkencor duke shkruar librin **El-Kanun**, të cilin ia ka kushtuar Mes'udit.^[14] Me vrasjen e Mes'udit në një ekspeditë ushtarake, në vitin 1040, vendin e tij e pason Mevdudi, i cili thuhet se kishte treguar një respekt të veçantë kundrejt dijetarit të madh. Vetë Biruni do t'i kushtojë sultan Mevdudit librin **Kitab el-Destur**. Po në Gazne ai do të shkruajë edhe librin **Kitabu's-Sajdala**, i cili njihet si libri i fundit i Birunit dhe që gjendet si dorëshkrim në bibliotekën e qytetit të Bursës, në Turqi. Në literaturën shkencore Biruni është konsideruar si një enciklopedist i cili ka shkruar në fusha të ndryshme të shkencës. Në lidhje me datën e tij të vdekjes ka mendime të ndryshme, por shumica e studiuesve mendojnë se ai vdiq në Gazne, në vitin 1048, në moshën 75-vjeçare.^[15]

A. Personaliteti i tij shkencor

Sartoni, për të treguar rëndësinë e Birunit dhe ato që ai i dha njerëzimit, e ka quajtur kohën kur Biruni ishte në jetë si “shekulli i Birunit.”^[16] Sepse gjuhët që ai njihje, shkencat me të cilat ai merrej dhe rezultatet shkencore që ai arriti, mjaftojnë për ta vendosur emrin e tij ndër më të mirët në historinë e njerëzimit. Studiuesi Arthur Upham Pope shprehet se nuk quhet e plotësuar historia e matematikës, astronomisë, gjeografisë, antropologjisë e historisë së religjioneve, pa theksuar kontributin e Birunit. Udhëtimi shkencor e kishte shoqëruar atë për gjithë jetën, duke shkruar shumë vepra në disiplina të ndryshme. Elementi më i rëndësishëm në veprat e tij është metodologjia në kërkime dhe objektivizmi në studimet e veta.^[17] Ende në ditët e sotme, objektivizmi i Birunit në trajtimin e temave vijon të jetë shembull për shumë studiues. Një fakt tjetër, i cili nxjerr në pah anën e tij shkencore, është dhe debati që ai kishte zhvilluar me filozofin e madh Ibn-i Sina.^[18] Vetë Biruni merrej edhe me filozofi, madje studiuesit shprehen se ai kishte shkruar vepra kundër ndjekësve të ekolit aristotelist.^[19] Ai, gjithashtu merrej edhe me funksionet trigonometrike të aritmetikës, në të cilat thuhet se kishte arritur përfundime të rëndësishme.

Biruni kishte arritur t'i zhvillonte më shumë sinuset, kosinuset dhe tangjentet, duke iu shtuar atyre dhe funksionet e sekanteve, kosekanteve dhe kotangjentëve. Ndërsa në lidhje me kërkimet mbi astronominë dhe vëzhgimet që ai kishte bërë, mësohet të ketë shkruar edhe një vepër. Siç u theksua edhe më sipër, Biruni është marrë edhe me shkenca të tjera pozitive, si fizikë, kimi etj., në lidhje me të cilat ka lënë vepra të shkruara. Në veprat e Birunit rëndësi të veçantë zë gjeografia dhe studimet që kanë lidhje me këtë fushë. Studiuesit shprehen se veçanërisht në shek. X, në botën islame, janë bërë shumë kërkime mbi gjeografinë. Në saj të këtyre studimeve janë hedhur themelet e gjeografisë matematikore, e cila do të kthehet në disiplinë shkencore po nga ana e Birunit. Këto arritje në fushën e sipërcituar, ai do t'i përmbledhë në veprën **Tahdid Nihajat el-Emakin**. Në anën praktike, ai ndërmori një nismë që nuk ishte marrë kurrë më parë. Me sistemin që kishte ndërtuar arriti të përllogarisë me një përqindje gabimi gati të papërfillshme koordinatat e hapësirës midis Gaznes dhe Bagdatit, qytete të cilat ndaheshin në një distancë dhe hapësirë më shumë se 2000 km.^[20]

Ndër fushat, në lidhje me të cilat Biruni është marrë më së shumti, spikat edhe ajo e historisë. Studiuesit shprehen se ai ka lënë punime të vyera mbi historinë e popujve, kronologjinë dhe fusha të tjera të ngjashme me historinë. Studimet e tij, në lidhje me historinë e religjioneve, janë përdorur nga studiues të shumtë për shekuj me radhë. Arsyeja e përdorimit të studimeve të tij për një kohë kaq të gjatë ka lidhje me metodologjinë që ai kishte përdorur në hulumtimet e tij, por edhe me tematikën e punimeve të tij, të cilat ishin unike për shumë kohë.

B. Disa vepra të rëndësishme të Birunit

Studiuesit nuk kanë dhënë një numër të saktë të veprave të shkruara nga ana e Birunit. Kjo, për faktin se numri i librave të tij që kanë arritur në ditët tona është shumë i paktë, krahasuar me ato që i atribuohen atij në burime të ndryshme. Përveç atyre që do të paraqiten këtu, Biruni ka shkruar edhe shumë vepra të tjera në fusha të ndryshme, si: për llogaritjen e moshës së indianëve, mbi sportin e shahut, astronominë, astrologjinë, mineralet, gurët e shtrenjtë etj. Në ***Enciklopedinë Islame***, të botuar në Turqi, janë prezantuar njëzet vepra të

Birunit, të cilat mendohet se kanë arritur deri në ditët tona, por numri i punimeve të këtij kolosi është shumë herë më i madh.^[21] Këtu do të mjaftohemi duke paraqitur të dhëna në lidhje me disa vepra kryesore të Birunit:

1. El-Asaru'l-Bakije ani'l Kuruni'l- Alije: Është njëra ndër veprat më kryesore të Birunit dhe mendohet të jetë shkruar në vitin 999, kur Biruni ishte në moshën 30- vjeçare. Aty janë trajtuar kalendarë dhe data festash të ndryshme të popujve të vjetër. Në libër jepen të dhëna edhe mbi shumë çështje e ngjarje të historisë së Harezmit. Është cilësuar si libri më gjithëpërfshirës midis të gjitha veprave të dijetarëve myslimanë në lidhje me kronologjinë. Ka njëzet kapituj dhe në pjesën e hyrjes së versionit të përkthyer në anglisht jepen të dhëna mbi jetën e Birunit, por janë shtuar edhe elementë të parë si të nevojshëm.^[22]

2. Kitabu't-Tahkik ma li'l-Hind: Është shkruar në vitin 1030 dhe për shumë shekuj ka qenë libri më voluminoz mbi indianologjinë. Punimi trajton kulturën, gjuhën, besimin, natyrën dhe elemente të tjera të qytetërimit indian. Përgatitja në arabisht e librit është realizuar në vitin 1887, ndërsa përkthimi në gjuhën angleze u bë në vitin 1888 për t'u botuar nga C. Edward Sachau në Londër, në vitin 1910. Në pjesën e hyrjes së veprës, editori jep të dhëna mbi autorin, metodologjinë dhe kohën për të cilën libri bën fjalë.^[23]

3. Tahdidu Nihajatu'l Emakin li-Tashihi Mesafeti'l- Mesakin: Libri mendohet të jetë shkruar në vitin 1025, në Gazne. Vepra mbart studime në lidhje me gjeodezinë, por ka të dhëna edhe mbi gjeografinë, gjeologjinë, astronominë, astrologjinë dhe historinë. Aty jepen detaje për gjetjen e një mbishkrimi në pjesën e Afganistanit, ku jepen detaje mbi eklipse të ndryshme të ndodhura gjatë sundimit të perandorit Dioklecian (285-305). Dorëshkrimi i kësaj vepre sot gjendet në bibliotekën e Stambollit.

4. El-Kanunu'l-Mes'udi: Mendohet të jetë shkruar në vitin 1030 dhe pranohet si njëra ndër veprat e tij më të mëdha. Aty ka të dhëna mbi astronominë, astrologjinë, kronologjinë, gjeografinë, gjeodezinë, meteorologjinë, trigonometrinë dhe shumë shkenca të tjera. Për shumë studiues, nga kjo vepër ka tërhequr vëmendje të veçantë medotat matematikore që Biruni ka përdorur për matjen e dy objekteve gjeografikë me distanca të largëta.^[24] Studiuesit e

kanë cilësuar këtë punim si një enciklopedi. Libri është botuar në vitet 1954-1956 në formatin e tri vëllimeve.

5. El-Xhemahir fi'l Xhevahir: Libri është shkruar në vitet 1041-1049 dhe i është kushtuar sundimtarit Mevdudi. Në këtë vepër, ai kryesisht ka studiuar mbi gurët e shtrenjtë dhe mineralet e tjera. Gjithashtu, në të janë trajtuar shkenca të ndryshme, si: psikologjia, sociologjia, mjekësia, fizika, etnologjia, historia etj. Studiuesit e kanë cilësuar këtë punim si një pasqyrë të kohës së Birunit. Libri është botuar nga F. Krenkow në vitin 1936.

6. Kitab'us-Sajdala fi't-Tib: Në këtë vepër ai na del përpara edhe si një filolog, ku jep të dhëna mbi aspekte të gjuhëve të ndryshme. Punimi është i përbërë nga hulumtime në fushat e mjekësisë dhe farmaceutikës, ku Biruni ka studiuar mbi shumë lloje bimësh dhe përdorimin e tyre si ilaçe. Gjithashtu, emrat ilaçeve jepen në shumë gjuhë, si: arabisht, persisht, turqisht, greqisht dhe në shumë dialekte të tjera.

7. Kitab fi'sti'abi'l-Vuxhuhi'l-Mumkine fi San'ati'a-Asturlab: Kjo vepër e Birunit mbi astrolabin është në formën e dorëshkrimit dhe gjendet në shumë biblioteka të botës. Mbi këtë punim janë bërë shumë studime, por përkthimi i plotë i veprës nuk është kryer akoma.^[25] Në këtë punim gjendet edhe një metodë trigonometrike për matjen e perimetrit të tokës, e cila më vonë do të testohet në Nandana të Indisë.

8. Et-Tefhim fi Eva'ili Sina'ati't-Tenxhim: Mendohet që shkrimi i librit të jetë përfunduar në vitin 1029. Është një vepër e shkruar në formën e një hyrjeje në astronomi, por në të janë trajtuar edhe fusha të tjera, si: matematika, astrologjia dhe gjeografia. Punimi gjendet në gjuhën arabe dhe perse. Më vonë do të përkthehet edhe në gjuhën angleze nga Ramsay Wright (London 1934).

9. Terxhemetu Kitabı Batenzhel fi'l-Halas mine'l-Irtibak: Këtë vepër Biruni e kishte përkthyer nga sanskritishtja në gjuhën arabe. Bëhet fjalë për *Yogasutra*'n e Patanjalit. Kjo vepër shumë e rëndësishme është përgatitur për botim nga ana e H. Ritter me titull *Albiruni's Übersetzung des Yoga-Sutra des Patanjali*.

C. Metodologjia e Birunit

Njëra ndër veçoritë më kryesore që e ndan Birunin nga dijetarët dhe shkencëtarët e tjerë të kohës është metodologjia që ai ka përdorur në studime. Në veprat e tij, Biruni, parashtron në mënyrë të detajuar cilësitë, qëllimin dhe

mënyrën se si një studiues duhet ta zhvillojë hulumtimin e vet. Pasi shpreh cilësitë dhe përgatitjen e studiuesit, Biruni më pas ndalet në temën se si mund të përgatitet një punim me nivel të mirë. Më pas, ai ndalet edhe në aspektet e metodologjisë, paradigmave, analizave dhe krahasimeve, elementë të cilët janë gurë kilometrikë në përgatitjen e një studimi.^[26] Nevojën e metodologjisë në një studim ai e thekson kështu:

“Nëse një autor nuk do t'i përmbahet në mënyrë të përpiktë metodës shkencore, atëherë ai do të prodhojë disa të dhëna sipërfaqësore, të cilat nuk do të kënaqin as ata që e njohin doktrinën, por edhe të tjerët që e dinë temën. Në këtë rast, nëse ai do të ketë një karakter të vërtetë do të ndihet i turpëruar; por, nëse ai është aq i ulët sa të mos e vlerësojë të vërtetën, ai do të këmbëngulë për originalitetin e pikëpamjes së vet...”^[27]

Eduard Sachau e ndan në tri pjesë metodologjinë e përdorur nga Biruni në veprën e tij **tahkik**. Ai, kur flet në lidhje me kulturën apo besimet e indianëve, nuk zgjedh të përdorë fjalët e veta, por citon dijetarët apo klerikët indianë. Sachau e shpjegon metodologjinë e Birunit me këto fjalë: *“ai e prezanton qytetërimin indian, ashtu siç e vizatojnë vetë indianët veten e tyre”*.^[28] Biruni fillimisht bën një prezantim të shkurtër të temës. Më pas transmeton të dhënat në lidhje me atë temë nga dijetarë të ndryshëm indianë, të cilët e njohin më së miri traditën. Ky aspekt është tejet i rëndësishëm për Birunin, ku ai shprehet: *“Pjesa më kryesore dhe esenciale e botës së mendimit indian, është ajo çfarë mendojnë dhe besojnë Brahmanët, kjo është ajo për të cilën aao janë përgatitur për të ruajtur fenë e tyre...”*^[29] Dhe së treti, e plotëson temën duke e krahasuar me mendime apo teori të besimeve apo qytetërimeve të ndryshme që kanë ngjashmëri me temën në fjalë. Në këtë mënyrë edhe lexuesi e ka shumë më të lehtë ta kuptojë temën e trajtuar në libër. Në procesin shkencor, vërejmë që Biruni udhëhiqet vetëm nga mendja e logjika. Kjo është dhe arsyeja që ai është shumë objektiv në hulumtimet, kritikën apo rregullimet që bën në tema të caktuara. Biruni preferon hulumtimin dhe studimin përpara transmetimit apo imitimit dhe shprehet që midis këtyre koncepteve ka shumë diferencë. Për Birunin nuk ka vlerë ai që mëson përmendësh, imituesi apo ai që nuk hulumton me imtësi. Për të, parësore janë cilësia, argumenti dhe veçoritë. Vrojtimi dhe eksperimenti bëjnë pjesë në metodat kryesore të

kërkimeve të Birunit. Në veprat e shumta që ka shkruar, ai vetë shprehet për nevojën e meto-dave shkencore në studime, aspekt të cilin e ka aplikuar edhe vetë më së miri.

Një kriter tjetër i rëndësishëm në metodologjinë e Birunit konsis-ton edhe në elementin kritik. Ai i kontrollon të gjitha të dhënat që i janë transmetuar nga librat dhe të dhënat më të hershme. Natyrisht që për Birunin ato të dhëna apo dije të cilat bien ndesh me logjikën mbeten të kontestueshme dhe për këtë arsye ai përdor kritikën në veprat e tij. Në lidhje me këtë çështje, vetë Biruni, e shpreh nevojën e metodës kritike në studime përmes një pyetjeje që shtron: *“Dhe, si mundemi ne t’i besojmë një të dhënë e cila është e kundërt me perceptimet tona?”*^[30] Pra, informacionet që ai merr, i kalon në sitën e transmetimeve më të hershme mbi temën, në tekstet dogmatike dhe më në fund i analizon ato sipas elementit logjik.

D. Koncepti i Birunit për historinë dhe të dhënat mbi besimet e tjera

Biruni ka dhënë një kontribut të çmuar edhe në kritikën dhe filo-zofinë e historisë. Vepra e tij më e rëndësishme në lidhje me këtë temë është **El-Asaru’l-Bakije**. Të dhënat që ai jep në lidhje me zonën e Harezmit, kanë një rëndësi burimore të dorës së parë. Ai është dëshmitar i kohës dhe i vendit në të cilin jeton dhe këtë e ka transmetuar përmes veprave që ka lënë pas. Biruni i ka dhënë historisë një shpirt filozofik, duke e trajtuar atë në këndvështrime të ndryshme si atë sociale, ekonomike e poli-tike. Sepse historia për të ishte një shkencë e vështirë, por në të njëjtën kohë edhe shumë e rëndësishme. Ai e shpreh vetë këtë element kur thotë: *“Jeta e një njeriu nuk mjafton për të kërkuar dhe nxjerrë në dritë të dhënat e një populli.”*^[31] Biruni e studion historinë e botës sipas principeve gje-ologjike. Ndërsa kahu tjetër i rëndësishëm në trajtimin e tij është ai i zhvillimeve ekonomike. Sipas tij, historia konsiston në transmetime të përbashkëta të njerëzve, të për-jetuara në një kohë e të pran-uara nga ana e një kombi, dhe ky prag e përbën edhe nisjen e historisë.^[32] Lajmet apo të dhë-nat e kohëve të hershme, të cilat nuk mund të përcaktohen, stu-diohen sipas krahasimeve logjike. Këto janë arsyet që Biruni i jep rëndësi të veçantë metodologjisë në studimin e historisë. Për të qenë një histori-an i mirë, studiuesi duhet ta

njohë shumë mirë faktorin gjeografik. Ky element te Biruni del në pah në mënyrën më të qartë. Ai i jep në mënyrë të mirëpërcaktuar pozicionet gjeografike, distancat, drejtimet e lumejve, të cilët janë elementë të rëndësishëm në analizmin dhe interpretimin e ngjarjeve historike. Në shumicën e veprave të tij, ai i jep një rëndësi të veçantë aspektit gjeografik. Studiuesit theksojnë që të dhë-nat e tij mbi gjeografinë janë shumë të sakta, krahasuar edhe me matjet e ditëve të sotme. Një fushë tjetër e historisë, në të cilën veprat e Birunit vijnë ende të jenë të rëndësishme është dhe ajo e religjioneve. Në librat e tij ka të dhëna mbi bes-ime të ndryshme, si: besimet e grekëve të lashtë, budizmi, hin-duizmi, zarathustra, maniheiz-mi, sabiizmi, judaizmi dhe samiritë, kristianizmi, paganiz-mi arabik dhe islami.^[33] Libri më i rëndësishëm i tij mbi his-torinë e religjioneve është **Kitabu’t-Tahkik ma li’l-Hind**, që studiuesit e shohin si një vepër me vlerë në këtë fushë, pavarë-sisht faktit që kanë kaluar pothuajse njëmijë vjet nga shkrimi i tij. Shumica e të dhë-nave në lidhje me hinduizmin dhe budizmin gjenden në këtë vepër, ku ai jep informacion të detajuar mbi këto dy besime. Siç u theksua edhe më sipër, për të kuptuar më mirë këto besime dhe botëkuptimet e tyre Biruni fillimisht kishte mësuar sanskri-tishten, e cila ishte dhe çelësi kryesor që i ka hapur atij këtë botë të veçantë, siç ishte qytetërimi indian bashkë me besimet e veta. Po në kontekstin e kuptimit, studimit dhe trans-metimit të të dhënave mbi bes-imet e sipërcituara, duhen parë edhe veprat që ai ka përkthyer nga Samkhja dhe Patanjali. Të dhënat që Biruni jep në lidhje me judaizmin dhe samiritë janë interesante. Edhe pse ai thekson se është takuar me dijetarë e pri-jës të judaizmit, burimet të cilat ai i përmend në disa raste rezul-tojnë edhe të dorës së dytë. E njëjta gjë ndodh edhe me komunitetin e samirive, të cilët janë shumë më të paktë në numër krahasuar me hebrenjtë. Ai i përmend këto besime me emra të ndryshëm, por i trajton ato nën një kapitull dhe mendo-het të theksojë ngjashmëritë që ekzistojnë midis tyre. Biruni gjithashtu jep të dhëna edhe mbi krishtërimin. Sipas të dhënave që jep në veprat e tij, mendohet që Biruni i kishte njo-hur të tri grupet e krishtera të Lindjes, siç ishin melkitët, jako-bitët dhe nestorianët. Në veprat e tij, ai jep të dhëna mbi krishtërimin në përgjithësi, citon nga Bibla dhe jep edhe opinione ose mendime të dije-

tarëve të krishterë, me të cilët kishte korrespondencë. Gjithashtu, jep të dhëna të deta-juara edhe mbi sektet heretike të krishtera, të cilat ekzistonin në kohën e Birunit dhe gjeografinë në të cilën ai jetoi, duke i krahasuar elementë të ndryshëm të këtyre besimeve me fenomene të ngjashme të besimeve të tjera.


Përfundim

Në artikull u mundua të prezan-tohet te studiuesi dhe lexuesi shqiptar një autoritet shkencor i botës islame, siç ishte Ebu Rejhan el-Biruni. Dimensioni i tij enciklopedik e bën atë një personalitet, i cili është shumë para kohës në të cilën ai ka jetu-ar. Këtu vlen të vlerësohet kë-mbëngulja e tij për dijen dhe shkencën, por edhe vendos-mëria për të ndjekur vetëm logjikën dhe objektivitetin në studimet që Biruni ka kryer. Veçanërisht metodologjia që ai ka përdorur në hulumtime, ende sot është objekt analize për shumë studiues. Përmes Birunit ne kuptojmë edhe pro-filin e shkencëtarit të shek. X-XI. Ai fillimisht përballej me mungesën e literaturës. Për të mësuar e studiuar dhe për ta siguruar këtë, duhej të hynte nën shërbimin e një sundimtari ose duhej të udhëtonte për ta gjetur dijen. Mbi të gjitha ai duhej t’i kryente studimet e veta nën presionin e lufrave, duke mos qenë i sigurtë dhe i ekspozuar para rreziqeve të tjera të kohës. Në këtë kontekst, duhet theksuar që Biruni është shembulli më i mirë i shkencë-tarit të shek. XI. Një përfundim tjetër ka lidhje me një dimension më të gjerë, me marrëdhënien dhe ndërveprimin midis qytetërimeve. Edhe nëse midis civilizimeve të ndryshme ka ekzistuar një rivalitet për domin-im ekonomik, politik, ushtarak e kulturor, mund të thuhet lir-shëm që shkenca këtu bën për-jashtim. Studimet dhe arritjet shkencore kanë qenë rezultat i akumulimit të eksperiencës dhe dijes njerëzore dhe janë trans-metuar nga njëri qytetërim në tjetrin, duke mundësuar për-parimin dhe zhvillimin e njerëzimit. Menjëherë, pas fuqizimit të qytetërimit islam, sundimtarët myslimanë kanë hedhur një hap të rëndësishëm duke përkthyer në gjuhën arabe mijëra vepra të grekëve të lashtë dhe qytetërimeve të tjera mesd-hetare. Në saj të këtyre, myslி-manët arritën përparime të jashtëzakonshme në fushat e shkencës. Arritjet e tyre iu trans-metuan europianëve, duke hed-hur kështu themelet e

qytetërimit të sotëm perëndi-mor. Është pranuar botërisht se Andaluzia ka qenë adresa e studimit të shumë kolosëve të qytetërimit perëndimor. Veprat e Ibn Sinas, Ibn Rushdit dhe dije-tarëve të tjerë janë mësuar për shumë shekuj në katedrat europiane. Vetëm **El-Kanunu’l-Mes’udi** është mësuar për 400 vjet. Kjo vepër, por edhe libra të tjerë të Birunit që u cituan këtu, tregojnë edhe njëherë person-alitetin shkencor të këtij kolosi, por edhe faktin që dija dhe dije-tarët janë vlerë e përbashkët e gjithë njerëzimit.

[1] Arthur Upham Pope, “Alberuni as a Thinker”, Al-Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. 281.
[2] Ebu Reyhan El-Biruni, Maziden Kalanlar, Çev. Ahsen Batur, Selenge Yay., stanbul: 2011, f. 12.
[3] Günay Tümer, Biruni’ye Göre Dinler ve slam Dini, Diyanet İeri Bakanlı Yayınları, Ankara: 1991, f. 35.
[4] Kamar Oniah Kamaruzaman, The Works and Contributions of Abu Rayhan Muhammad bin Ahmad Al-Biruni, The International Institute of Islamic Thought and Civilization, Kuala Lumpur: 2003, f. 29.; Fuat Sezgin, İslam’da Bilim ve Teknik, Çev. Abdurrahman Aliy, V. I, BB Kültür A. . Yay., stanbul: 2008, f. 25.; Al-Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. XIV.
[5] Günay Tümer, “Biruni”, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, TDV Yay., İstanbul: 1992, f. 206.
[6] Në antikitet, Harezmi është njohur si Chorasmi. Shih: Suniti Kumar Chatterji, “Al-Biruni and Sanskrit”, Al-Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. 83.
[7] Al-Biruni, f. XV.
[8] El-Biruni, Maziden, f. 10.
[9] Në lidhje me praninë e Birunit në sarajin e sulltanit, studiuesit shpre-hen se ai është gjendur aty për arsye studimi. Duke patur parasysh kohën në të cilën ai ka jetuar, është i qartë fakti që ishin shumë të pakta bib-liotekat në të cilat mund të studioje. Natyrisht që vendet më të pasura me literaturë dhe dorëshkrime të ndryshme kryesisht ishin ambientet si sarajet e sundimtarëve apo të princërve ku Biruni është gjendur në moshën e tij të hershme. Shih. El-Biruni, Maziden, f. 10.
[10] Kamaruzaman, The Ėorks, f. 30-31.; El-Biruni, Maziden, f. 11.
[11] Kamaruzaman, The Works, f. 32.; Al-Biruni, f. XV.; Chatterji, Al-Biruni, f. 85.; El-Biruni, Maziden, f. 11.
[12] Jacques Waardenburg, Müslümanların Di er Dinlere Bakı ları, Çev. Fuat Aydın, Ensar Ne riyat, stanbul: 2013, f. 77.; Kamaruzaman, The Works, f. 32.
[13] Alessandro Bausani, “L’India Vista da Due Grandi Personalita’ Musulmane: Babar e Biruni”, Al-Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. 55-60.
[14] Kamaruzaman, The Works, f. 33.
[15] Një pjesë tjetër e studiuesve mendojnë që Biruni ishte në moshën 79 ose 81 vjeç kur ai vdiq. Al-Biruni, f. XVI.
[16] Sartoni shprehet për Birunin kështu: “Ai ishte një udhëtar, një filo-zof, matematicien, gjeograf dhe enciklopedist. Ai ishte më i madhi i dijetarëve myslimanë dhe njëri ndër më të mëdhenjtë e dijetarëve të gjithë botës.” Ndërsa Jacques Boilot thotë: “El-Biruni, i cili në të vërtetë ishte shumë para kohës së vet është

një paraprirës i mirëkuptimit të ndërsjelltë dhe të një marrëdhënie ndërkulturore midis Lindjes dhe Perëndimit.”. El-Biruni, Maziden, f. 32-33.
[17] A. Jeffery, “Al-Biruni’s Contribution to Comparative Religion”, Al- Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. 126-127.; Pope, Alberuni, f. 285.
[18] Ibn Sina ishte 11 vjet më i vogël se Biruni dhe sipas studiuesit të shkencave islame Fuat Sezgin, në kohën kur ka ndodhur ky debat ai ishte vetëm 17 vjeç. Mes tyre janë diskutuar çështje shumë të vështira, si shpejtësia e dritës apo dhe se si ngrohet toka dhe në fund të letërkëmbimeve Biruni e ka lavdëru-ar Ibn Sinan si një shkencëtar të ri. Shih: Sezgin, İslam’da Bilim, V. I, f. 31.; Muhammed Tanci, “Beyruni’nin bn-i Sina’ya Yöneltti i Bazı Sorular, bn-i Sina’nın Cevapları ve bu Cevaplara Beyruni’nin tirazları”, Beyruni’ye Arma an, TTK Yay., Ankara: 1974, f. 231.
[19] Tümer, Biruni, f. 209.; Pope, Alberuni, f. 282.
[20] Fuat Sezgin, İslam’da Bilim ve Teknik, Çev. Abdurrahman Aliy, V. I, BB Kültür A. . Yay., stanbul: 2008, f. 12.
[21] D. Ahsen Batur që ka përkthyer në turqisht veprën El-Asaru’l Bakije, i referohet dijetarit Jakut el-Hamevi që thotë se Biruni gjatë jetës së tij kishte shkruar mbi 180 vepra, të cilat ishin rreth 13.000 fletë. Në fund të veprës është dhënë një listë e librave që i atribuohen Birunit. Shih: El-Biruni, Maziden, f. 18- 19, 400-409.
[22] El-Biruni, The Chronology of Ancient Nations, Translated and Edited by Edëard Sachau, Publishers to the India Office, London: 1879, f. IV-V.; el-Biruni, Maziden, f. 21.; Kamaruzaman, The Ėorks, f. 52-53.
[23] El-Biruni, Tahkik ma li’l-Hind, Translated and Edited by Edëard Sachau, Munshiram Manoharhal Publishers Pvt. Ltd., New Dehli: 19100, f. VII-XLIX.; Chatterji, Al-Biruni, f. 83.; El-Biruni, Maziden, f. 25.
[24] J. H. Kramers, “Al-Biruni’s Determination of Geographical Longitude by Measuring the Distances”, Al-Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. 179-193.
[25] Syed Hasan Barani, “Muslim Researchers in Geodesy”, Al-Biruni, Commemoration Volume A.H.362-A.H.1362, Council of the Iran Society Publications, Calcutta: 1951, f. 33-39.; Tümer, Biruni, f. 213.
[26] Në lidhje me aspekte të ndryshme të metodologjisë së për-dorur nga Biruni shih: Kamaruzaman, The works, f. 75.
[27] Kamaruzaman, The Works, f. 78; El-Biruni, India, s. 6.
[28] El-Biruni, India, s. XXIV.
[29] Kamaruzaman, The Works, f. 87.
[30] Kamaruzaman, The Works, f. 97.
[31] El-Biruni, Asar, f. 5.
[32] Fillimin e historisë Biruni e shp-jegon në këtë mënyrë: “Historia është një hapësirë kohore, e cila ka nisur nga dita e parë e një viti të cak-tuar. Mund të jetë dërgimi i një pro-feti të pajisur me mrekulli të ndryshme, hipja në fron e një mbreti të fuqishëm e despot, përballja e një populli me ndonjë përmbytje, fatke-qësi, epidemi apo zi, ndërrimi dorë i pushtetit, ardhja e një populli të ri në vend të atij ekzistues ose ndodhja e një ngjarjeje të madhe qiellore, ngjarje të rëndësishme që mund të ndodhin në tokë përmenden me një datë të caktuar.” El-Biruni, Maziden, f. 52.
[33] Jeffery, Al-Biruni’s Contribution, f. 140-141.; Pope, Alberuni, f. 283.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Karrica për çmimin ‘Ylli i javës’ në Superligë: Sukses i gjithë ekipit



PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 35-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të KF Ballkanit, Bernard Karrica. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Lulzim Berisha, Avni Shala dhe Enes

Shosholli. Ky komision ka vendosur që çmimi “Ylli i javës” për xhiron e 35-të t’i jepet Bernard Karrisës, i cili me golin që shënoi në këtë ndeshje ia dhuroi fitoren Ballkanit, njëherësh ky gol ia siguroi titullin e kampionit të tretë radhazi skuadrës nga Suhareka, një javë para përmbylljes së edicionit. Pasi mori këtë çmim, Bernardi u shpreh i lumtur që u

vlerësua më i miri i javës dhe që skuadra e tij e arriti objektivin e parë të këtij edicioni. “Ndeshja e djeshme ishte kritike për kampionatin tonë, duke pasur parasysh që ishte vendimtare. Jam shumë i lumtur që me golin që shënova arritëm të fitojmë dhe të shpallemi kampionë. Ky është sukses i gjithë ekipit”, ka thënë Karrica për faqen zyrtare të FFK-së.

Bashkëpunimi me Serbinë, ‘TKZ’, aksion kundër FShF-së

TIRANË, 20 MAJ - Kandidatura e përbashkët e Federatës Shqiptare të Futbollit me Federatën e Futbollit të Serbisë për organizimin e “Euro 2027” për U21 ka sjellë reagimin e madh të tifogrupit “Tifozët kuqezi”. “TKZ” shkruan se do të kundërshtohet çdo nismë e cila ka synim rregullimin e marrëdhënieve me një vend që gjithmonë ka luftuar kundër Shqipërisë. “Kundërshtojmë çdo nismë që mundohet t’i rregulloj imazhin

një populli barbar e gjenocidal. Kundërshtojmë çdo bashkëpunim me vrasësit me ata që shkaktuan me qindra masakra ndaj shqiptarëve dhe që deportuan me miliona nga shtëpitë e tyre gjatë gjithë historisë”, thuhet në reagimin e tifozëve kuqezi. Mbështetësit e kombëtares shqiptare nuk kanë “qëndruar duarkryq” duke postuar vetëm në rrjetet sociale, pasi tashmë po protestohet edhe para selisë së FShF-së.



Nis rrënimi i stadiumit, KF Rahoveci: Nga sot nuk kanë ku të stërviten fëmijët e shkollës së futbollit



RAHOVEC, 20 MAJ - Komuna e Rahovecit ka vendosur ta rrënojë stadiumin e qytetit në Rahovec “Jahja Danuza” dhe në vendin e tij ta ndërtojë sheshin qendror të këtij qytetit. Rrënimi i stadiumit nga punëkryerësi i kontraktuar ka nisur të hënën, andaj KF Rahoveci ka reaguar me anë të një komunikate, duke shprehur shqetësimin se nga sot e tutje as gjeneratat e reja nuk kanë ku t’i zhvillojnë stërvitjet. “Ne si klub kishim një marrëveshje paraprake me Komunën e Rahovecit të cilët na kishin premtuar dhe janë zotuar që stadiumi i qytetit nuk do të rrënohet pa u krijuar një alternativ tjetër për të zhvilluar

garat dhe për të stërvitur, ne në vazhdimësi kemi komunikuar me DKRS-në të cilët janë të njoftuar mirë me kërkesat tona elementare për të na mundësuar kushte optimale për të zhvilluar gara dhe për tu stërvitur. Realisht komuna na ka mirëkuptuar dhe priti përfundimin e kampionatit që ne ta përfundojmë në shtëpinë tonë, por që tani brenga jonë është shkolla e futbollit ku janë të anëtarësuar qindra fëmijë e që fatkeqësisht nga sot nuk kanë ku të stërviten përderisa nuk përfundojnë punimet në qendrën e re sportive! Lutemi dhe urojmë në një zgjidhje sa më të shpejtë t’i bëhet shqetësimeve tona”, thuhet në reagimin e KF Rahoveci.

Zhegrova: Sezon pozitiv, faleminderit të gjithëve për mbështetjen!

Lille, 20 maj - Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Edon Zhegrova, pati një sezon fantastik me Lillen, me të cilin e mbylli sezonin në

katërshen e parë të Ligës 1. Kjo ia mundëson këtij ekipi të luajë në garat evropiane edhe në sezonin e ardhshëm. Zhegrova ka bërë një postim në rrjetet sociale, përmes

të cilit i ka përgëzuar shokët e skuadrës për sezonin e bërë dhe i ka falënderuar tifozët për mbështetjen e vazhdueshme gjatë sezonit. “Punë mjaft e mirë e

krejt ekipit. Krenar me secilin. Faleminderit tifozëve dhe gjithkujt që na ka mbështetur gjatë këtij sezoni!”, ka shkruar Zhegrova në “Instastory”.



Kloppi: Nuk do të tërhiqem nga futbollli

LIVERPOOL, 20 MAJ - Trajneri Jurgen Klopp ka mohuar pretendimet se do të tërhiqet përgjithnjë nga futbollli pasi i dha lamtumirën klubit të Liverpoolit të dielën. Gjermani fitoi ndeshjen e fundit në "Anfield" (2-0 ndaj Wolves), duke i dhënë fund një periudhe nëntëvjeçare si

trajner i "Reds". I pyetur nëse do të rikthehet në futboll pas një pushimi të pritshëm, Kloppi u përgjigj: "Do të punoj sërish në të ardhmen. Sapo e kam mbaruar këtë punë ndaj nuk e di saktësisht kur kthehem. Por e kuptoj se kjo punë është si një drogë. Të gjithë kthehen dhe të gjithë

punojnë deri në moshën 70-vjeçare. Nuk është se po kërkoj për mundësinë e radhës dhe cilat klube janë në dispozicion për trajner të ri apo gjëra të tilla. Do të ketë mundësi për të folur, por nuk po mendoj për afate se ndoshta pas një viti do të rikthehem. Në këtë moment

mund t'ju them vetëm se do të shihemi së shpejti". "Nuk kam asnjë ide se çfarë do të bëj. Paketimet ndoshta. Unë kam mjaft gjëra për të bërë dhe jeta private duhet të planifikohet. Unë kam qenë këtu duke bërë gjëra dhe me siguri Ulla, gruaja ime, do të më përditësojë se ku do të



shkojmë. Nuk kam asnjë ide se çfarë po ndodh. Kemi një festë këto ditë", ka deklaruar Kloppi.

Guardiola: Realiteti është se jam më afër largimit sesa qëndrimit në City

MANCHESTER, 20 MAJ - Trajneri Pep Guardiola është tashmë në librin e historisë së Manchester Cityt dhe Premierë Ligës. Kampionati i tij i katërt radhazi anglez këtë vit, i gjashti në shtatë sezonet e fundit, e vendos atë në elitën e sportit në ishull. Që nga viti 2016 ai ka krijuar një projekt të lakmueshëm në "Etihad" pasi ka fituar 17 tituj (gjashtë Premierë Ligë, dy Kupa FA, katër Kupa të Ligës, dy Community Shields, një Ligë të Kampionëve, një Superkupë Evropiane dhe një Kupë të Botës për Klube) dhe City është bërë një makth për të gjithë në Angli dhe Evropë. Këtë sezon ai ka fituar tre trofe (Premierë, Superkupë Evropiane dhe Kupën e Botës për Klube) dhe një i katërti mund të shtohet nëse mposht Unitedin në finalen e FA Cup në "Wembley". Me një sezon të mbetur në kontratën e tij (kontrata e tij skadon në qershor të 2025-s), tekniku me përvojë foli për të ardhmen e tij



te City. "Realiteti është se jam më afër largimit sesa qëndrimit. Ne kemi folur me klubin dhe ndjenja ime tani është se dua të qëndroj. Unë do të qëndroj sezonin e ardhshëm dhe gjatë këtij sezoni do të flasim", ka thënë Guardiola. "Kur u transferova këtu, nëse dikush do të më thoshte se do të fitoja gjashtë kampionate në shtatë sezone, do të kisha thënë se ata ishin të çmendur. Tani është

koha jonë. Nuk po them se jam trajner i keq, por kam mbështetje të jashtëzakonshme nga klubi. Në fillim nuk e kemi menduar, por në janar apo shkurt kam menduar pse jo. Për shkak të përvojës sonë ne luftuam për tituj, por e morëm mesazhin. Ne e dimë se Arsenali do të jetë këtu për shumë vite. Arteta është një trajner i ri me talent të madh. Duhet të kemi kujdes", ka deklaruar Guardiola.

Përcaktohen finalet 'play-off' në të dyja Konferencat

NYU-JORK, 20 MAJ - Janë mbyllur ndeshjet gjysmëfinale "play-off" në të dyja Konferencat, duke përcaktuar edhe ekipet finaliste. Surpriza më e madhe është eliminimi i ekipit kampion në fuqi të Denver Nuggetsit, që u mund me shifrat 98-90 nga Minnesota në gjysmëfinalen e shtatë. Denveri edhe pse luante në fushën e tij nuk arriti të fitojë. Murray me 35 pikë e Jokiçi me 34 pikë e 19 rebounde mbetën të vetëm në lojën e ekipit vendës. Për miqtë, 6 lojtarë realizuan mbi 10 pikë (McDaniels e Towns nga 23 pikë secili). Minnesota fitoi 4-3 me ndeshje dhe në finale do të luajë me Dallasin, që befasoi duke mundur me rezultat 117-116 Oklahomën, e renditur në vendin e parë në përfundim të sezonit e rregullt. Teksanët fituan 4-2 me ndeshje. Vendimtar Luka Doniqi, autor i një "triple double", me 29 pikë, 10 rebounde e 10 asistime, mbështetur edhe nga Jones Jr. e Irving me nga 22



KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"
New York - Indiana 109-130 (3-4)
Boston - Cleveland (4-1)

Finale - "Play-off"
Boston - Indiana

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"
Denver - Minnesota 90-98 (3-4)
Oklahoma - Dallas 116-117 (2-4)

Finale - "Play-off"
Minnesota - Dallas

pikë secili. Për Oklahoman, Shai realizoi 36 pikë, por që mbetën për statistikë. Në Konferencën e Lindjes, Indiana është skuadra e dytë finaliste, që mundi 4-3 me

ndeshje New York. Skuadra e Indianas fitoi me shifrat 130-109 gjysmëfinalen e shtatë "play-off", sfidë ku u dallua Haliburton me 26 pikë.

SHKURT

Silvinho më 27 maj zbulon listën e futbollistëve për 'Euro 2024'

